
STATUTI

i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “Derma Health Albania” SH.P.K.

Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).
Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901,dt.14.04.2008“Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” I ndryshuar;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;
- QKB” – Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi.

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Me date 27/12/2023, ne te nenshkruarit:

Bledar Kaçiu, i datelindjes 17.11.1989, lindur në Krujë, mbajtes i Leternjoftimit me Numër Personal: I91117006R;

Denisa Kaçiu e datelindjes 11.01.1993, lindur ne Korce, mbajtes i Leternjoftimit me Nr Personal: J35111067R

Regjistrojmë nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “**“Derma Health Albania”**” Sh.p.k., bazuar ne akt themelimin e dates 27/12/2023.

Neni 2

Objekti

Import Eksport tregeti me shumice dhe pakice ne farmaci, klinika private, qendra estetike dhe online te produkteve per kujdesin e lekures, ofrimin trajtimeve estetike dhe sherbime mjeksore ne klinike, sherbimin e Fizioterapise, tregetim dhe dhenie me qera ne klinika private dhe qendra estetike te pajisjeve mjeksore dhe estetike. Ofrim trajnimesh per perdorimin e produkteve mjeksore dhe te estetikes dhe kujdesi n e lekures. Import eksport te souvenir, bizhu dhe artikuj te ndryshem artistik. Ofrim sherbimesh modelim I biznesit, analize dhe vlerësim të biznesit, shërbime konsulence, studim tregu dhe plan biznesi, keshillime mbi strategjitë e shitjeve,

keshillime mbi partneritetet etj. Përfaqësim dhe mbështetje për kompanite e huaja dhe Shqiptare në tregun shqiptar. Shërbime konsulence mbi dokumentacionin/aplikimet në institucionet shtetërore. Gjithashtu shoqëria mund të ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur me sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 3

Kohezgjatja

3.1. Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

Neni 4

Selia

4.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Rr. Kavajës, Kompleksi Square 21, Kati I parë Nr i Pasurisë 1/709+2-1 Kodi Unik 8250037232, Zona Kadastrale 8250

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali fillestar i kompanisë do të jetë 100.000 (lek) të ndarë në 2 kuota, nga të cilat ortakët themelues janë:

Bledar Kaçiu: Zoterues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë të barabartë me 50.000 (njëqindmijë lekë).

Denisa Kaçiu: Zoterues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë të barabartë me 50.000 (njëqindmijë lekë).

5.2. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

6.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

6.2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimmarres

8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “ç” te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

8.5. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

9.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

9.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

10.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50 per qind te kuotave.

10.2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

10.3. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;

- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - ç) percaktimin e shperblimeve
 - d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- 11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

13.1. Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

13.2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

13.3. Z. Bledar Kaçi i Leternjofitimit me Numër Personal: I91117006R do te jete Administrator i Pare e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuara “Derma Health Albania”.

Nr. Kontaktit te Shoqersise eshte: 0672002516

Emaili i Shoqerise: dermahealthalbania@gmail.com

Afati i Administratorit do jete per nje periudhe 5-vjecare.

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

14.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;

b) perfaqesojne shoqerine tregtare ne cdo institucion publik dhe jo publik duke përfshirë bankën e nivelit të parë dhe të dytë.

c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;

ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se

veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;

d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;

e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

e) perfaqeson kompanine ne cdo banke te nivelit te dyte dhe cdo institucion shteteror;

f) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

14.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjet me financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

14.4. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

15.1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2. Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga asamblëja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasoja të perkatese.

15.3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administrator detyrohet:

15.3.1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.3.2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve të perkatese, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.3.3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i demshperblejë shoqërisë demet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga keto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

15.4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i demshperblejë shoqërisë demet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesat apo dividendet;

c) u shperndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi të paguara për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

15.5. Përveç padisë për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është

e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

16.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

17.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'I shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V

Prishja –riorganizimi i shoqerise

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”;
- d) me vendim te gjykates;

18.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese“ Shoqeri ne likuidim e siper “.

18.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

18.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

20.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

ORTAKU I SHOQERISE "Bledar Kaçiu"

ORTAKU I SHOQERISE "Denisa Kaçiu"